



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 056/2021

Nr. Protokolli: 80/2021

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik SHQIPONJABFB SH.P.K.; Nazmi A. Pacolli B.I, Rruga Jasharajve 118, 31000, Gillogoc
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	27.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 25.05.2021, të parashtruar nga Operoret Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik SHQIPONJABFB SH.P.K.; Nazmi A. Pacolli B.I, Rruga Jasharajve 118, 31000, Gillogoc**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pije dhe shërbime të Byfësë për stafin e Komunës** me Nr. të Prokurimi: **624-21-2406-121 & 624-021-055-121** -nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës **25.05.2021** të parashtruar nga Operoret Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik SHQIPONJABFB SH.P.K.; Nazmi A. Pacolli B.I, Rruga Jasharajve 118, 31000, Gillogoc** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pije dhe shërbime të Byfësë për stafin e Komunës** kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës **17.05.2021** të publikuar në platformen elektronike.
2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK** të publikuar me datë: **20.05.2021**.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **25.05.2021**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Furnizim me pije dhe shërbime të Byfësë për stafin e Komunës** me Nr. të Prokurimi: **624-21-2406-121 & 624-021-055-121** kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të dates, **20 .05.2021** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe se pretendimet tuaja nuk qendrojnë, ngase në ofertën tuaj, **mungon çertifikata e TVSH-se për NAZMI A.PACOLLI B.I po ashtu edhe të përshkrimi I qimimeve keni ofertuar me normën e TVSH-së prej 8 %, ndërsa TVSH-ja është 18%.**

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

